Kronikë

Vlorë/ 46-vjeçari kërcënon me armë zjarri gruan dhe dy vajzat e tij, arrestohet nga 'Shqiponjat'! Tentoi të arratisej me motoçikletë (Video)

Një 46-vjeçar i cili dyshohet se ka kërcënuar me armë gjahu gruan dhe dy vajzat e tij është arrestuar ditën e sotme nga e Forcës së Posaçme "Shqiponja", në tentativë për t'u larguar me motoçikletë.

HOROSKOPI

Redaksia
3 Shkurt, 20:22 | **Përditesimi: 3 Shkurt, 20:33**

Share

Vlorë – Një 46-vjeçar i cili dyshohet se ka kërcënuar me armë gjahu gruan dhe dy vajzat e tij është arrestuar ditën e sotme nga Forcat e Posaçme "Shqiponja", të policisë.

46-vjeçari i identifikuar me inicialet "Sh.Xh., ka tentuar të arratiset me motoçikletë sapo ka parë forcat e policisë, por pa sukses.

Blutë bëjnë me dije se ngjarja ka ndodhur në lagjen "15 Tetori", ku dhe banonte familja.

[Sh.com]

LEXO EDHE:
Vlorë/ I dënuar me 2 vite e 8 muaj burg për armëmbajtje pa leje, arrestohet 36-vjeçari i shpallur në kërkim (VIDEO)

Ndër të tjera raportohet se janë sekuestruar në cilësinë e provës materiale, arma e gjahut çifte me të cilën 46-vjeçari kanosi familjarët, si dhe motoçikleta me të cilën tentoi të largohej.

> *"Pas marrjes së njoftimit, mbrëmjen e sotme, se një shtetas po kanoste për jetën, me armë gjahu çifte, bashkëshorten e tij dhe dy vajzat e tyre, në banesë, në lagjen "15 Tetori", shërbimet e Forcës së Posaçme "Shqiponjat" dhe të Komisariatit të Policisë Vlorë menjëherë kanë organizuar punën për parandalimin e ngjarjes së mundshme kriminale, dokumentimin e plotë ligjor të rastit dhe vënien e autorit përpara përgjegjësisë penale.*
>
> *Si rezultat i veprimeve të shpejta nga Policia, është kapur në flagrancë në tentativë për t'u larguar me një motoçikletë, shtetasi Sh. Xh., 46 vjeç",- njofton policia.*

Ndërkohë, vijon puna e grupit hetimor, për sqarimin e plotë të rrethanave të ngjarjes dhe për referimin e materialeve procedurale në Prokurori.

K.M/Shqiptarja.com

TAG: Vlore

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH.COM

Sondazhi i ditës:
Deklaratat publike të Arben Ahmetajt i konsideroni:

Të besueshme | Kërkon azil | S'e di

Lajme të tjera

Nga stadiumet dhuna zbret në parket, akuzon Vllaznia e Futsalit: Në Vlorë u dhunuam nga tifozët, ligji duhet të veprojë
3 Shkurt, 21:17

Vlorë/ Zjarri përfshin fushën në Triport, zjarrfikëset mbërrijnë në vendngjarje (VIDEO)
3 Shkurt, 21:01



Përfshihet nga flakët banesa në Vlorë
3 Shkurt, 20:37

Vlorë, 17 vjeçari kapet me doza kanasi gati për shitje në lagjet e qytetit
3 Shkurt, 15:13

Vlorë, mbillen 1500 fidanë në grykëderdhjen e Vjosës
3 Shkurt, 15:04

Çudia në Sarandë, priten me gërshërë pemët anës rrugës
3 Shkurt, 12:50

Vlorë, sherr mes të rinjve pranë Gjykatës, 3 goditet me thikë! Arrestohet njëri prej autorëve, tjetri në kërkim
3 Shkurt, 12:36

Pjesë e grupit që do trafikonin 500 kg kanabis në Turqi, arrestohet 48-vjeçari në Vlorë
3 Shkurt, 11:11

VIDEO/ Aksident në aksin Vlorë-Fier, dy të lënduar, dërgohen në spital
3 Shkurt, 09:57

Kujtohet 115-vjetori i shfaqjes së parë teatrale në Vlorë, 'Vdekja e Pirros' u vendos në skenë në janar 1908, i parapriu shpalljes së pavarësisë

Armand Xhelili
2 Shkurt, 16:42

U arrestua ditën e djeshme, GJKKO lë në burg pjesëtarin e grupit kriminal për kalimin e paligjshëm të emigrantëve (EMRI)
2 Shkurt, 16:10

Vlorë/ E reja kallëzon 34-vjeçarin: Më ka hapur llogari në rrjetet sociale dhe më përndjek
2 Shkurt, 14:26

Kodi Etik | Kontakt | Rreth Nesh | Raportoni Ju | Puno me ne

[Shqiptarja.com]

Kërko

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje